




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. DPKI	Nr. Prot. 06-799/20
Dep. DPKI	Br. Prot. 06-799/20
Nr. lfaq. 02	Data 13.03.2020
Broj stranica 02	Datum 13.03.2020
Nr. pages 02	Date 13.03.2020



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1, nenit 5, paragrafi 1 pika 1.5, nenit 18, paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 11.03.2020, mori këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti me nr. *AKK-DPKI-01/19/026*, për zyrtaren e lartë znj. Xhezide Dragusha, Këshilltare Komunale në Kuvendin e Komunës së Obiliqit, për shkak të është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë në rast se paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli *AKK-DPKI-01/19/026*, që për trajtim ka pasur zyrtaren e lartë znj. Xhezide Dragusha, Këshilltare Komunale në Kuvendin e Komunës së Obiliqit, është zhvilluar procedura e paraparë sipas Ligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Agjencia kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtutjeshëm: Agjencia), sipas detyrës zyrtare ka identifikuar rastin e konfliktit të interesit, sipas të cilit znj. Xhezide Dragusha, krahas ushtrimit të funksionit si zyrtare e lartë publike, respektivisht Këshilltare Komunale në Kuvendin e Komunës së Obiliqit, e njëjta ishte si Person i Autorizuar në biznesin privat "Xhezide Dragusha" B.I. Përmes shkresës zyrtare *AKK-DPKI-06-01/19*, Agjencia fillimisht ka kërkuar nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (në tekstin e mëtutjeshëm: ARBK), verifikimin dhe konfirmimin e informacionit lidhur me biznesin e cituar mësipër. Nga përgjigja e ARBK-së (shkresa zyrtare nr. *AKK-DPKI-06-2337-1/19*), rezulton se zyrtarja e lartë znj. Xhezide Dragusha është pronare dhe person i autorizuar në biznesin në fjalë.

Me rastin e konfirmimit të informacionit të mësipërm, Agjencia në pajtim me nenin 22, paragrafin 3 dhe 5 të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit





Publik, e ka njoftuar zyrtaren e lartë znj. Xhezide Dragusha për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit, përmes shkresës zyrtare AKK-DPKI-06-01/026, dhe se në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të kësaj shkrese, ajo ka të drejtë të njoftohet gjerësisht me faktet që posedon Agjencia lidhur me rastin në fjalë.

Pas pranimit të kësaj shkrese, me kërkesë të zyrtares së lartë, Agjencia ka organizuar dhe mbajtur një takim brenda ambienteve të saj, ku e njëjta është njoftuar gjerësisht lidhur me faktin se, gjatë ushtrimit të funksionit publik, ajo nuk mundet që njëkohësisht të jetë edhe Person i Autorizuar në biznesin privat, sepse kjo situatë paraqet gjendje të papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik, dhe si e tillë bie ndesh me nenin 13, paragrafi 1 të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, ku përcaktohet se:

*“Zyrtarja e lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit”.*

Pas diskutimit dhe ballafaqimit të fakteve, zyrtarja e lartë znj. Xhezide Dragusha është pajtuar me gjetjet e Agjencisë, duke deklaruar se do të ndërmarr veprime të menjëhershme dhe konkrete në mënyrë që të shmang papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit publik.

Ndërkohë, Agjencia përmes emalit zyrtar ka pranuar nga pala shkresën “Kërkesë për Vërtetim Tatimor” drejtuar Administratës Tatimore të Kosovës, me qëllim të mbylljes së biznesit në fjalë. Në mungesë të ndërmarrjes së veprimeve tjera procedurale nga ana e palës dhe për shkak të rrjedhjes së afateve ligjore procedurale, Agjencia i ka dërguar palës Njoftimin paralajmërues për konstatimin e konfliktit të interesit.

Mëpas, Agjencia ka pranuar shkresën zyrtare (DPKI-06-734/20), me të cilën dëshmohet se zyrtarja e lartë znj. Xhezide Dragusha ka shuar në tersi biznesin dhe e njëjta nuk figuron më të jetë Person i Autorizuar e as pronare e biznesit privat “Xhezide Dragusha” B.I.

Me veprimet e ndërmarra nga zyrtarja e lartë znj. Xhezide Dragusha, Këshilltare Komunale në Kuvendin e Komunës së Obiliqit, duke shuar biznesin në fjalë, janë krijuar rrethana të reja me çfarë është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik për zyrtaren e lartë. Prandaj, në bazë të asaj që u tha më sipër, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18, paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtaren e lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit